



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenit 9 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019 dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 30. 10. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR KOORDINIMIN E PROCESIT TË**  
**ZGJEDHJEVE TË KËSHILLAVE LOKALE**

**Neni 1**  
**Përbërja e Komisionit**

Me këtë Vendim formohet Komisioni për koordinimin e procesit të zgjedhjeve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Hyra Bytyçi, nga subjekti politik LDK, Kryesuese
2. Lumturije Bytyqi-Hasani, nga subjekti politik PDK, anëtare
3. Shkelzen Bislimi, nga subjekti politik LVV, anëtar
4. Ganimete Qeriqi, nga subjekti politik AAK, anëtare
5. Avni Olluri, nga ekzekutivi i Komunës, anëtar
6. Denis Gashi, nga shoqëria civile, anëtar
7. Përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagjja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal, anëtar

**Neni 2**  
**Mandati i anëtarëve**

Mandati i Komisionit është i lidhur me me mandatin e Kuvendit të Komunës.

**Neni 3**  
**Detyrat e Komisionit**

Komisioni Komunal ka për detyrë të organizojë zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane si dhe të kryej detyra tjera të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane Nr. 15-020-63687 të datës 24.09.2019.

**Neni 4**  
**Kompensimi i punës së komisionit**

Për punën e tij Komisioni do të kompensohet në vlerë prej 30 € (tridhjetë euro) për pjesëmarrje në secilin takim të mbajtur në fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane i cili do të evidentohet në procesverbal. Pagesa do të bëhet nga buxheti i Komunës –kategoria ekonomike- mallra dhe shërbime.

**Neni 5**  
**Punët administrative - juridike të Komisionit**

Punët administrative - juridike të Komisionit do ti kryej Drejtorati për Administratë - Sektori për punë të Kuvendit dhe të Komiteteve.

**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr.15- 013-70948  
Lipjan, më 31. 10. 2019

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Daut Azemi**

